VENDIM
Nr. 202, datë 23.6.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 116, DATË 24.5.2022, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'SPV BLUE 1' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK 'BLUE 1', ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1135/10 prot., datë 22.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'SPV Blue 1' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik 'Blue 1', me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw', i ndryshuar"

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 116, datë 24.5.2022, i ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 10.8.2022, vendosi të licencojë shoqërinë "SPV Blue 1" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Blue 1", me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar duke filluar nga data e operimit por jo më vonë se data 1.7.2023.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135/9 prot., datë 12.6.2023, i licencuari "SPV Blue 1" sh.p.k. ka kërkuar ndryshimin e datës së fillimit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, duke argumentuar, se edhe pse punimet për realizimin e Parkut Fotovoltaik "Blue 1" në zonën Sheq Marinas, Fier janë drejt përfundimit, energjizimi tij mbetet në funksion të ecurisë së realizimit të projektit të ndërtimit të nënstacionit 220/110/35/20 kV dhe linjës së transmetimit 220 kV Hoxharë e Re – Fier (Fier - Babicë), ndaj vendosja në operim e Parkut Fotovoltaik "Blue 1" nga shoqëria "SPV Blue 1" sh.p.k. nuk mund të realizohet përpara datës 1.4.2024.

- Në këto rrethana, shoqëria "SPV Blue 1" sh.p.k. ka kërkuar nga ERE ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, i ndryshuar, duke referuar si datë të fillimit të operimit të parkut fotovoltaik "Blue 1", datën 1 prill 2024.

- Për sa më sipër argumentohet nga shoqëria, në rrethanat kur nuk ka filluar ende me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar vlerësojmë të justifikuar kërkesën e saj për të filluar afatin 25-vjeçar të vlefshmërisë së licencës nga data e përditësuar tashmë e operimit, duke marrë në konsideratë se ndryshimi i datës së fillimit të afatit të vlefshmërisë së licencës nuk tejkalon as afatin e kontratës nr. 2720 rep. dhe nr. 2066 kol., të datës 9.7.2021, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe shoqërisë "SPV Blue 1" sh.p.k., në cilësinë e Mbajtësit të Miratimit Përfundimtar.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

"1. Të licencojë shoqërinë "SPV Blue 1" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Blue 1", me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar, duke filluar nga data e operimit, por jo më vonë se data 1.4. 2024.".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 1" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe "Furnizuesin e Tregut të Lirë" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti